



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:256576
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697108

K.Dh.Sh.II.nr.1648/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.P.N “Vision Projekt”, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KA.nr.4/22 të datës 29.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit N.P.N “Vision Projekt” me seli në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KA.nr.4/22 të datës 29.09.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KA.nr.4/22 të datës 29.09.2022, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.P.N “Vision Projekt” me seli në Gjilan, ndërsa ka mbetur në fuqi vendimi nr.472/2017 i datës 15.01.2018 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave materiale, me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, të anulohet në tërësi si i pabazuar aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe

Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.472/2017, të datës 15.01.2018, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.472/2017 të datës 15.01.2018 për subjektin NPT “Vision Projekt“ me NRB: 70605554, NRF: 600009577, me pronar z. Sh.M., me seli të biznesit në rr.Adem Jashari p.n, -Viti, në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë vërtetohen si të bazuara.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 08.02.2018, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.472/2017, të datës 15.01.2018, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, ekspertizës financiare të datës 19.05.2022, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ka theksuar se për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.213/18 të datës 13.10.2021 ka caktuar ekspertizë financiare, përmes të cilës e ka obliguar ekspertin financiar që të konstatoj librat e shitjes-blerjes, transaksionet bankare, deklaratimet e tatimpaguesit, të gjitha këto për periudhën kontestuese të vitit 2014-2016, duke krahasuar me Raportin e Kontrollit sipas të cilit raport është vlerësuar se paditësi duhet të paguajë tatimin shtesë në vlerë prej 629,336.72 €. Eksperti financiar M.P., në ekspertizën e datës 19.05.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë mendimin dhe konstatimin se pas pranimit të librave të shitjeve dhe blerjeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhe pas analizës së tyre eksperti financiar ka konstatuar se me përjashtime të caktuara të paraqitjeve të vlerave financiare, tatimpaguesi i ka mbajtur evidencat në mënyrë të rregullt për të gjitha vitet 2014,2015 dhe 2016, por që të njëjtat vlera nuk i ka deklaruar përmes deklaratave taimore të TVSH-së, respektivisht të gjitha deklaratimet i ka bërë me zero, në kohën kur ka pasur aktivitete të shitjes, e që është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-222 për ATP, respektivisht me nenin 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 (për 01/2014-09/2015) dhe të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015). Si rrjedhojë, Tatimpaguesi nuk mund të shfrytëzoj TVSH-në e zbritshme në blerjet e bëra, dhe njëkohësisht nuk e ka shfrytëzuar mundësinë kohore të përcaktuar me nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, në kohën kur ka pasur të drejtën e zbritjes, jo më larg se periudha e fundit e vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Po ashtu, eksperti financiar ka konstatuar se në faqen 3 të vendimit Nr.472/2017 të ATK/D/A, nga ATK-ja janë precizuar ligjet e përdorura në periudhat përkatëse, respektivisht

neni 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 për TVSH-në për periudhën (01/2014 – 09/2015), dhe nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015). Ndërsa sa i përket aseteve të shitura të cilat sipas paditësit nuk duhet të trajtohen si mallra, por me rastin e shitjes si fitim apo humbje kapitale, Ekspertit Financiar në takimin e datës 11.05.2022 nuk ka mundur ti dëshmojë të kundërtën e vlerësimit të ATK-së të bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, derisa për pikën e precizuar referuar një bageri se i njëjti ka qenë i prishur dhe është shitur nën çmimin e tregut dhe si rezultat kanë pas humbje kapitale, eksperti financiar ka konstatuar se këtu paditësi nuk ka mundur ti dëshmojë ekspertit financiar të kundërtën e vlerësimit të ATK-së, respektivisht nuk është paraqitur ndonjë vlerësim/konstatim profesional lidhur me nivelin e dëmtimit të pasurisë së shitur nën çmimin e tregut. Eksperti financiar ka vërtetuar konstatimet e të paditurës edhe lidhur me 14 faturat shitëse të kontestuar, se të njëjtat përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 45, të ligjit mbi TVSH-në nr. 03/L-146 dhe 05/L-037 dhe se të njëjtat janë të nënshkruara nga paditësi. Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i'a dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur dhe sqarimeve të ekspertit në seancë, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe e arsyetuar mjaftueshëm e të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Kosovë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që e paditura nuk e ka pranuar TVSH-në e zbritshme për vitin 2014, 2015 dhe 2016, pastaj pretendimin tjetër se në raport të kontrollit janë përfshirë faturat e një kompanie tjetër, si dhe ka konsideruar të pabazuar pretendimin e të paditurës kur asetet i ka trajtuar si shitje, Kolegji i kësaj gjykate i trajtoi të gjitha këto pretendime dhe konsideron se sa i përket pranimin të TVSH-së në blerjet e vitit 2014, 2015 dhe 2016, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi për këto periudha kohore deklarimet në ATK i ka bërë më zero edhe pse librat dhe regjistrimet i ka mbajtur në mënyrë të rregullt, ndërsa ka humbur të drejtën e zbritjes së TVSH-së pasi që paragrafi 2 i nenit 38 të Ligjit 03/L-037 parasheh që “Nëse personi i tatueshëm nuk e zbrit TVSH-në e tij të zbritshme në këtë periudhë tatimore, ai mund ta zbres këtë shumë të TVSH-së së zbritshme në çdo kohë pas kësaj periudhe tatimore, mirëpo, jo më vonë se në periudhën e fundit tatimore të vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin ai e ka pasur të drejtën që të zbres TVSH-në e zbritshme”. Sa i përket pretendimit për përfshirjen në raport të kontrollit

faturat e një kompanie tjetër, kolegji i kësaj gjykate konsideron se të njëjtat fatura i përmbajnë të gjitha elementet që duhet t'i ketë një faturë për tu konsideruar e rregullt, duke përfshirë këtu edhe vulën e nënshkrimit e të dy subjekteve në faturë. Edhe pretendimi i fundit i paditësit për trajtimin e aseteve si shitje gjykata e konsideron si të pabazuar pasi që paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi as para të paditurës dhe as para gjykatës për të vërtetuar të kundërtën e asaj që është konstatuar nga e paditura.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. .

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1648/22, me datë 16.05.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova